



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

Nr. 586 Akti

Nr. 627 Vendimi  
Tiranë, më 2.3.2023

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Olsi Komici</b>	Kryesues
<b>Xhensila Pine</b>	Relatore
<b>Firdes Shuli</b>	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Jonida Vrana, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në datën 28.2.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore lidhur me çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Shqiponja Milla**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, përfaqësuar nga av. Romina Zano.

**OBJEKTI:** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, dëgjoi subjektin dhe përfaqësuesen e saj ligjore në seancë dëgjimore, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

1. Znj. Shqiponja Milla është subjekt rivlerësimi bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për shkak të funksionit të saj si prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

2. Bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, znj. Shqiponja Milla i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.12.2019 me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Olsi Komici, Firdes Shuli dhe Xhensila Pine (relatore).

3. Komisioni ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

4. Trupi gjykues, pas studimit të raporteve të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, filloi hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Trupi gjykues caktoi kryesues komisionerin Olsi Komici dhe deklaroi mungesën e konfliktit të interesit.

5. Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Shqiponja Milla për të tria kriteret e rivlerësimit; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave dhe thirrjen e dëshmitarëve, si dhe afatin e ushtrimit të tyre.

6. Në datën 10.2.2023 subjektit iu dërguan rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit për sjelljen e provave dhe shpjegimeve, për të provuar të kundërtën e barrës së provës.

7. Trupi gjykues, pas marrjes së provave dhe shpjegimeve nga subjekti i rivlerësimit, ka vendosur ta ftojë atë në seancën dëgjimore në datën 28.2.2023, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, Tiranë.

## **I. SEANCA DËGJIMORE**

8. Në datën 28.2.2023, ora 10:00, u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit dhe përfaqësueses së saj ligjore, si dhe vëzhgueses ndërkombëtare, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

8.1. Seanca dëgjimore u ndërpre për të vazhduar me shpalljen e vendimit të trupit gjykues në datën 2.3.2023.

## **II. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

9. Subjekti i rivlerësimit Shqiponja Milla ka qenë bashkëpunuese gjatë procesit administrativ, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

## **III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

#### **A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

10. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me këtë subjekt rivlerësimi, ka konstatuar:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin financiar të pasurisë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

## **A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

11. Komisioni kreu një hetim të pavarur, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimet nr. 2 dhe nr. 17 të vitit 2017 të Gjykatës Kushtetuese, duke kryer një sërë veprimesh verifikuese hetimore për verifikimin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklarimit të bërë nga ky subjekt, të dhënave të pasqyruara dhe përfundimeve të nxjerra nga kontrolli i kryer nga ILDKPKI-ja, bazuar në dokumentacionin dhe provat shkresore të administruara në dosje.

12. Nga analiza e të dhënave të vetëdeklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike/vjetore dhe në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuara në ILDKPKI, verifikimi i materialeve shkresore dhe të dhënave të përfituara gjatë hetimit administrativ, kryer nga Komisioni, për pasuritë e subjektit dhe personave të lidhur me të, kanë rezultuar si vijon:

### **13. Apartament me sip. 107.1 m<sup>2</sup>, ndodhur në Shkodër**

13.1. Në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit deklaroi: “*Apartament me sip. 107.1 m<sup>2</sup>, në lagjen ‘\*\*\*’, blerë me kontratën datë 22.6.2015, në vlerën 46.000 euro. Burim krijimi: (i) shuma 24.000 euro e përfituar nga shitja e apartamentit në lagjen ‘\*\*\*’, p. \*\*\*, k. \*\*\*; (ii) shuma 3.000.000 lekë marrë nga ‘\*\*\*’ me kontratën për kredi afatgjatë nr. \*\*\*, datë 25.6.2015; (iii) shuma 1.000 euro e shtuar nga të ardhurat cash*”.

13.2. Në rubrikën “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” subjekti ka deklaruar *kontratë kredie bankare, datë 25.6.2015, “\*\*\*”, me afat 30.6.2025, shuma 3.000.000 lekë, me qëllim blerje apartamenti në lagjen “\*\*\*”, Shkodër, me sip. 107.1 m<sup>2</sup>.*

13.3. Në deklarin periodik vjetor të vitit 2015 subjekti i rivlerësimit bën të njëjtin deklarin lidhur me këtë apartament.

13.4. Agjencia Shtetërore e Kadastrës Drejtoria Vendore Shkodër konfirmon në bashkëpronësi të shtetasve Shqiponja Milla dhe Z. M. apartamentin me sipërfaqe totale 107.1 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, duke vendosur në dispozicion:

### **Lidhur me saktësinë e deklarimit dhe mospërputhjet e konstatuara**

13.5. Kontrata përfundimtare e shitblerjes së apartamentit, datë 22.6.2015, me objekt “shitjen e apartamentit të banimit me sip. 107.1 m<sup>2</sup>, në vlerën 46.000 euro”, ka përcaktuar në përmbajtjen e saj se çmimi është likuiduar në dy këste: (i) shuma 24.000 euro është derdhur në numrin e llogarisë së shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. pranë “Union Bank”; dhe (ii) shuma 22.000 euro është likuiduar sipas kontratës së sipërmarrjes.

13.6. Kontrata paraprake e shitblerjes së apartamentit ka përcaktuar në përmbajtjen e saj se çmimi 46.000 euro do të likuideohej: (i) 24.000 euro kalim me bankë; (ii) 22.000 euro do të likuideohej sipas mandatit nga firma; dhe (iii) 21.000 euro do të paguheshin me financim nga “\*\*\*\*”.

13.7. Lidhur me mospërputhjen e mësipërme, konstatuar në kontratat e lidhura nga subjekti dhe personi i lidhur, për sa i përket çmimit të kësaj pasurie dhe modaliteteve të pagesës së tij në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka vendosur në dispozicion: (i) pagesat e kryera prej saj dhe personit të lidhur për blerjen e këtij apartamenti; (ii) 5 kontrata të ngjashme në të njëjtën godinë në periudhën 2014 – 2017, ku provohet se çmimi i shitjes së tyre është i njëjtë me çmimin që subjekti ka blerë apartamentin; (iii) faturë shitjeje, datë 22.6.2015, e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. në emër të shtetasve Z. dhe Shqiponja Milla, për kontratën nr. \*\*\*, në vlerën 46.000 euro; dhe (iv) deklaratën e administratorit të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

13.8. Komisioni i kërkoi informacion edhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. për mënyrën e likuidimit të çmimit të referuar në kontratën e shitjes, e cila në përgjigje të saj informoi se vlera totale e apartamentit prej 46.000 euro të blerë nga subjekti dhe personi i lidhur ishte paguar në dy këste: (i) kësti i parë në datën 15.5.2015, me transfertë bankare në llogarinë në euro të shoqërisë në “Union Bank”, për shumën 24.000 euro; dhe (ii) kësti i dytë në datën 1.7.2015, me transfertë bankare në llogarinë e shoqërisë, për shumën 3.000.000 lekë.

13.9. Nga informacioni i përcjellë nga OTP Bank<sup>1</sup> rezultoi se subjekti dhe bashkëshorti i saj gjatë aplikimit për kredi në datën 17.4.2015 kanë depozituar kontratën paraprake të sipërmarrjes datë 7.4.2015, sipas së cilës çmimi 46.000 euro do të paguhet me dy këste: 21.000 euro do të paguhet me financim nga “\*\*\*\*”; dhe pjesa tjetër do të paguhet nga vetë blerësit.

13.10. Komisioni kërkoi informacion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër/Pukë lidhur me çështje penale të hetuara me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. apo ortakun (ët)/administratorin (ët)/përfaqësuesin e administratorit për raste të mundshme të konfliktit të interesit, nga të cilat nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë për konflikt interesi për subjektin e rivlerësimit.

13.11. Në kontratën e hipotekimit nr. \*\*\*, datë 25.6.2015, me palë hipotekuese Z. M. dhe Shqiponja Milla dhe palë përfituese “\*\*\*\*”, referohet se shtetasit Z. M. dhe Sh. M. janë bashkëpronarë mbi pasurinë nr. \*\*\*.

13.12. Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 3, i kërkoi subjektit sqarime, e cila në përgjigje të saj shpjegoi se përpilimi i kontratave dhe praktikave përkatëse ka qenë detyrë e noterit dhe nga ana e saj nuk është vlerësuar se duhej të kontrollonte me imtësi çdo detaj të kontratave.

13.13. Më tej, subjekti deklaroi se banesa e vetme që ka blerë është ajo që citohet në certifikatën e pronësisë, me nr. pasurie \*\*\*, dhe nuk ka asnjë lloj marrëdhënieje me banesën me nr. pasurie \*\*\*, duke paraqitur edhe përgjigjen e ASHK-së Shkodër, ku konfirmohet se kjo pasuri i përket shtetasit H. D.

13.14. Komisioni kërkoi informacion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër lidhur me çështje penale të hetuara me shtetasin H. D., për raste të mundshme të

---

<sup>1</sup>Shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 28.9.2022.

konfliktit të interesit dhe nga përgjigjet nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë për konflikt interesi për subjektin e rivlerësimit.

### **Lidhur me burimin e deklaruar dhe mundësinë financiare**

*i) Shuma 24.000 euro e përfituar nga shitja e apartamentit në lagjen “\*\*\*\*”, Shkodër*

13.15. Në deklaratën *Vetting* dhe në DPV/2015, subjekti i rivlerësimit deklaroi si burim krijimi për apartamentin me sip. 107.1 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, edhe shumën 24.000 euro të përfituar nga shitja e apartamentit në lagjen “\*\*\*\*”, p. \*\*\*\*, k. \*\*\*\*.

13.16. Si pjesë të dosjes *Vetting*, subjekti ka bashkëlidhur: (i) kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*\*, datë 15.8.2001, me palë blerëse Z. M., për blerje apartamenti me sip. 57 m<sup>2</sup>, lagjja “\*\*\*\*”, Shkodër, vlera 800.000 lekë, e likuiduar totalisht + kartela e pasurisë së apartamentit me sip. 57 m<sup>2</sup>, në pronësi të shtetasit Z. M.; (ii) kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*\*, datë 6.5.2015, me palë shitëse Z. M. dhe palë blerëse S. B., për shitje apartamenti me sip. 57 m<sup>2</sup>, lagjja “\*\*\*\*”, Shkodër; (iii) kërkesë për transfertë në “\*\*\*\*”, datë 6.5.2015, sipas së cilës shtetasi S. B. urdhëron kalimin e shumës prej 24.000 euro në favor të noteres M. D., me përshkrimin “për tjetërsim prone”.

13.17. Agjencia Shtetërore e Kadastrës Drejtoria Vendore Shkodër konfirmon për Komisionin shitjen e apartamentit me sip. 57 m<sup>2</sup>, lagjja “\*\*\*\*”, Shkodër dhe se shtetasi S. B. ka blerë nga shtetasi Z. M. apartamentin me kontratë shitjeje datë 6.5.2015, kundrejt çmimit 24.000 euro.

13.18. Sipas informacionit nga “\*\*\*\*” rezultoi se në llogarinë bankare të shtetasit Z. M. në datën 13.5.2015 është transferuar shuma 3.360.000,00 lekë nga znj. M. D., me përshkrimin “tjetërsim prone”, tërhequr *cash* nga llogaria e personit të lidhur.

13.19. Në vijim, personi i lidhur me subjektin, z. Z. M., në datën 15.5.2015 ka depozituar *cash* shumën 24.000 euro në “Union Bank”, e cila është transferuar për shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., me përshkrimin “blerje apartamenti 2+1”.

13.20. Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë nga ana e personit të lidhur, bashkëshortit të saj, në vitin 2001.

*ii) Shuma 3.000.000 lekë nga kredia datë 25.6.2015, nga “\*\*\*\*”*

13.21. Në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit deklaroi se për apartamentin me sip. 107.1 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, ka shërbyer si burim krijimi edhe shumën 3.000.000 lekë, marrë nga “\*\*\*\*” me kontratën për kredi afatgjatë nr. \*\*\*\*, datë 25.6.2015.

13.22. Si pjesë të dosjes *Vetting*, subjekti ka bashkëlidhur: (i) kontratë kredie nr. \*\*\*\*, datë 25.6.2015, për marrje kredie në shumën 3.000.000 lekë; (ii) kontratë hipotekimi nr. \*\*\*\*, datë 25.6.2015, ku për kredinë e marrë në shumën 3.000.000 lekë pala hipotekuese ka lënë si garanci apartamentin me sip. 107.1 m<sup>2</sup>, në Shkodër, në favor të palës përfituese.

13.23. Referuar të dhënave nga OTP Bank, për sigurimin e kredisë sipas kontratës së hipotekimit është referuar numri i pasurisë \*\*\*\*.

13.24. Shuma u përfitua nga kredia në datën 30.6.2015 dhe pagesa për apartamentin u krye në datën 2.6.2015, ndaj kredia nuk u përfshi në analizën financiare si burim krijimi i kësaj pasurie.

*iii) Shuma 1.000 euro nga të ardhurat cash*

13.25. Subjekti i rivlerësimit, në deklarin e interesave privatë para fillimit të detyrës në datën 5.11.2008, ka deklaruar shumën prej 2.000.000 lekësh në gjendje *cash*, kursyer nga puna e bashkëshortit në emigracion, në aktivitetin privat, si dhe paga në Shkollën e Magjistraturës për periudhën 2006 – 2008.

13.26. Referuar deklarinave të subjektit gjendja e likuiditeteve *cash* të akumuluar deri në datën 31.12.2014 rezultojn në vlerën 500.000 lekë.

13.27. Në deklaratën e interesave privatë periodikë për vitin 2015, në seksionin “ndryshimet e pasurive dhe burimet e krijimit”, ka deklaruar “pakësim i likuiditetit *cash* me vlerë 300.000 lekë (1.000 euro për blerje të ap. 2+1, si dhe shpenzime të tjera noteriale, në ZVRPP)”.

13.28. Në pyetësorin nr. 3, subjekti ka pretenduar se në vitin 2009 gjendja e likuiditeteve *cash* në banesë është shtuar me 500.000 lekë, shumë e tërhequr nga kredia nga Fondi Besa, por e papërdorur për aktivitetin e bashkëshortit.

13.29. Komisioni, në shqyrtim të deklarinave të subjektit dhe jurisprudencës së Kolegjit, vlerësoi që si burim për krijim të gjendjeve *cash* të merret në konsideratë vlera në këtë deklarin prej 2.000.000 lekësh dhe se gjendja *cash* e pretenduar e shtuar në vitin 2009 nuk mbështetet nga deklarinat periodike të vitit 2009 të subjektit të rivlerësimit.

13.30. Duket se subjekti nuk ka pasur gjendje *cash* të llogaritur deri në datën 31.12.2014, që mund të përdorej si burim për këstet e apartamentit dhe shpenzimet e ndryshme të deklaruara nga subjekti për vitin 2015.

13.31. Sa më sipër, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1.1.2015 – 2.6.2015, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit dhe personit të lidhur për të paguar shumën 46.000 euro dhe për kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për këtë periudhë, nga e cila rezultoi një pamundësi financiare për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve, duke rezultuar me një balancë negative prej -2.636.251 lekësh.

**13.32. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa duket se:**

- Ka mospërputhje në lidhje me mënyrën e pagesës së çmimit, numrin e pasurisë objekt kontrate dhe palët nënshkruese.

- Subjekti nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën e çmimit të blerjes së apartamentit deri në datën 2.6.2015 dhe mungesë të burimeve financiare për vitin 2015.

- Subjekti ka barrën e provës për të shmangur, tej çdo dyshimi të arsyeshëm, që nuk ndodhet në situatën e parashikuar nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, në lidhje me pasurinë nr. \*\*\*.

**Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me saktësinë e deklarinimit**

13.33. Pas kalimit të barrës së provës lidhur me mospërputhjet në dokumentacionin ligjor të hartuar për përfitim e kësaj pasurie, subjekti ka shpjeguar se: “*Dokumentet për aplikimin për kredi, ashtu si çdo dokument tjetër ligjor lidhur me blerjen e pasurisë së vetme që unë kam blerë nga subjekti ‘\*\*\*’ sh.p.k., ajo me nr. \*\*\*, nuk janë përgatitur nga ana ime apo e*

*bashkëshortit tim, por nga noterja V. H., ku janë nënshkruar fillimisht kontrata paraprake dhe më pas kontrata e shitjes. Në vijim, dokumentet e tjera, kontrata e kredisë dhe kontrata e hipotekimit janë përgatitur nga noterja L. H. Gabimet që mund të jenë bërë derivojnë nga gabimet e noteres V. H. në përgatitjen e praktikave përkatëse për bankën, ku ne kemi aplikuar dhe kemi marrë kredinë në shumën 3.000.000 lekë”.*

13.34. Subjekti gjithashtu ka shpjeguar se: *“Kam dhënë shpjegime dhe prova me të cilat provohet plotësisht që bëhet fjalë për një gabim në kontratën e hipotekimit lidhur me bashkëpronësinë time dhe të bashkëshortit tim mbi pasurinë nr. \*\*\*, gabim i cili është korigjuar nga vetë banka në praktikën e tyre, duke vendosur numrin e saktë të pasurisë për të cilën unë dhe bashkëshorti im rezultojm bashkëpronarë, pasurisë me nr. \*\*\*, dhe se personi i lidhur (bashkëshorti) Z. M. në datën 15.5.2015 ka kryer transfertë në shumën 24.000 euro për shoqërinë ‘\*\*\*’ sh.p.k. në vazhden e gabimeve të bëra si pasojë e gabimeve të noterit në përpilimin e kontratës paraprake, pasi referenca për numrin e pasurisë për të cilin do të derdhej kjo shumë është marrë nga noteri dhe kontrata paraprake pjesë e praktikës së aplikimit për kredi.*

*Siç është provuar, pasuria me nr. certifikate \*\*\*, në kohën e kryerjes së kësaj transferte, nuk ka qenë në pronësi të shoqërisë ‘\*\*\*’, por në pronësi të shtetasit H. D. Së dyti, nuk ka sens juridik që kjo pasuri të rishitet sërish nga ish-pronari apo nga ana jonë të bëhet një transfertë në llogari të një personi jo pronar për blerjen e një pasurie të cilën ai nuk e ka në pronësi.*

*Nga shpjegimet dhe provat përkatëse, provohet plotësisht dhe përtej çdo dyshimi që nuk ndodhem në situatën e parashikuar nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 33, pika 5, germa ‘c’ e ligjit nr. 84/2016 në lidhje me pasurinë nr. \*\*\*.*

*Mënyra e përpilimit të kontratave duke përgatitur kopje praktikash me kontrata të ndryshme paraprake për blerjen e së njëjtës pasuri dhe rrjedhimisht duke krijuar një kaos me gabimet materiale në këto kontrata, gabime të cilat janë pasqyruar më pas edhe në kontratën e hipotekimit të lidhur nga ana jonë me ish-bankën ‘\*\*\*’ te një noter tjetër”.*

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me mundësinë financiare**

13.35. Lidhur me burimin e deklaruar, shitjen e pasurisë së bashkëshortit të krijuar në vitin 2001, subjekti shpjegoi: *“Dua të theksoj faktin që kjo pasuri nuk është krijuar gjatë martese dhe as në periudhën kur unë kam filluar ushtrimin e detyrës sime si prokuror. Në këto kushte, kërkoj që faktet e mësipërme të merren parasysh edhe nën dritën e frymës së Kolegjit lidhur me pasuritë apo të ardhurat e vëna përpara emërimit në detyrë dhe përpara martese”.*

13.36. Lidhur me burimin e deklaruar, kredinë bankare, subjekti shpjegoi: *“Me të gjitha provat u provua plotësisht që shuma e përfituar nga kredia me datë 30.6.2015 (3.000.000 lekë) ka shërbyer pikërisht për pagesën e çmimit të këtij apartamenti.*

*Kontrata datë 22.6.2015 është mbyllur nga pala shitëse në mirëbesim, pas marrjes së njëjës pjesë të pagesës, asaj prej 24.000 euro me transfertë bankare me garancinë që kishte marrë paraprakisht nga pala blerëse dhe banka që këtë pjesë të mbetur, pikërisht çmimin 22.000 euro, do ta merrte menjëherë pas disbursimit të kredisë, siç edhe ka ndodhur në fakt”.*

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

13.37. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës dhe deklaratimet e saj në seancën dëgjimore – arsyeton se:

13.38. Pikat 1, 2 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pika 1 e nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, pika 7 e udhëzimit të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, si dhe formulari i deklaratimit të pasurisë për procesin e rivlerësimit, detyron subjektin e rivlerësimit për deklarin saktësisht dhe mjaftueshmërisht të pasurisë dhe të personave të lidhur me burimin në momentin e krijimit të saj, ku me burim në këtë rast përfshihet origjina, veprimi i ligjshëm që passjell disponimin dhe të drejtat pronësore të pasurisë, si dhe mjetet financiare për krijimin e saj.

### **Lidhur me saktësinë e deklaratimit**

13.39. Siç është provuar nga hetimi administrativ në kohën e hartimit të dokumentacionit ligjor për përfitimin e pasurisë nga ana e subjektit dhe bashkëshortit të saj, pasuria e përmendur në dokumentacionin e hartuar nuk ka qenë në pronësi të shoqërisë, por në pronësi të shtetasit H. D., i cili që në vitin 2012 e kishte regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme.

13.39.1. Duke qenë se kjo pasuri e paluajtshme nuk ishte më në pronësinë e shoqërisë ndërtuese 3 vjet përpara se të përmendej gjatë hartimit të dokumentacionit ligjor për shitblerjen e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, Komisioni vlerësoi se pasuria me nr. certifikate \*\*\* nuk rezultoi të ketë qenë në shitje nga ana e shoqërisë, ndaj dhe referenca lidhur me këtë pasuri është bërë bazuar në të dhëna të gabuara në kontratën paraprake dhe të kredisë.

13.40. Komisioni ka kërkuar informacion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër lidhur me çështje penale të hetuara me shtetasin H. D. për raste të mundshme të konfliktit të interesit dhe nga përgjigjet nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë për subjektin e rivlerësimit, si dhe ka kryer hetim lidhur me pasuritë dhe mundësitë financiare të këtij shtetasi, i cili rezultoi të kishte disa pasuri të paluajtshme dhe gjendje në llogarite bankare dhe nuk gjeti asnjë lidhje ndërmjet tyre dhe subjektit të rivlerësimit.

13.41. Nga vlerësimi i të gjithë situatës në tërësi, trupi gjykues vlerëson se nuk ka kushte për të krijuar dyshime për fshehjen e pasurisë nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe nuk u konstatua asnjë veprim apo përpjekje e subjektit për të deformuar apo manipuluar të vërtetën në funksion të paraqitjes së rreme të të dhënave lidhur me pasurinë e saj.

13.42. Bazuar në faktet e dala nga hetimi administrativ pas kalimit të barrës së provës, Komisioni ka konstatuar se kontratat ishin me të njëjtat problematika lidhur me çmimin e mënyrën e pagesës dhe palët nënshkruese për përfitimin e kësaj pasurie. Rezultoi e provuar se çmimi i kësaj pasurie ishte në vlerën 46.000 euro.

13.43. Analiza e mospërputhjeve të konstatuara u krye nga Komisioni, duke u vlerësuar nëse në thelb të këtyre veprimeve gjendeshin elemente që përfaqësonin përpjekje të subjektit për të justifikuar pasuri të fituara me burime të paligjshme apo për të justifikuar mungesë burimesh të ligjshme, si dhe për të mbuluar deformimet në deklaratimet e bëra në deklaratën *Vetting*, qofshin ato fshehje të pasurive apo deklarime të rreme.



13.44. Në rastin objekt gjykimi, pasaktësitë në hartimin e dokumentacionit ligjor kanë ndjekur dhe afektuar njëri-tjetrin në funksion të financimit të blerjes së apartamentit të banimit, nëpërmjet përfitimit të një kredie.

13.45. Komisioni vlerëson se këto pasaktësi në dokumentacion nuk kanë afektuar deklarin e kësaj pasurie në deklaratën *Vetting* të vitit 2017 dhe nuk kanë pasur për qëllim fshehjen e pasurisë apo deklarin e pasaktë të të dhënave të kësaj pasurie në deklaratën *Vetting* dhe nuk konsiderohet se kanë afektuar me paligjshmëri burimin e krijimit të pasurisë objekt hetimi.

13.46. Për sa më sipër, pasaktësitë në dokumentacionin ligjor për përfitimin e pasurisë së paluajtshme objekt deklarimi në deklaratën *Vetting* janë vlerësuar nga trupi gjykues si pasaktësi në veprimin e ligjshëm që passjell disponimin e kësaj pasurie nga ana e subjektit dhe personit të lidhur me të.

13.47. Ky qëndrim i mbështetur në parashikimin e nenit 33, pika 5 dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, është analizuar i parë ngushtë me parashikimin në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, i cili kërkon si parakusht për përgjegjësinë disiplinore për efekt të këtij procesi që pasaktësitë, si premisë për shkarkim, të jenë kryer me qëllim fshehjen e pasurisë apo deklarin e pasaktë të të dhënave.

13.48. Në konkluzion të sa më sipër, në referencë të parashikimeve ligjore të nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi, në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, rrethanat e konstatuara lidhur me pasaktësitë në dokumentacionin ligjor nënshkruar nga subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk përbëjnë arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Shqiponja Milla dhe nuk kanë afektuar deklarin e kësaj pasurie të paluajtshme në deklaratën *Vetting* të vitit 2017.

### **Lidhur me mundësinë financiare**

13.49. Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me burimin e krijimit të këtij apartamenti, arsyeton se deklarin e dhëna nga subjekti i rivlerësimit lidhur me përdorimin e kredisë bankare si burim krijimi për këtë pasuri konsiderohen të besueshme, pasi në kontratën e kredisë nr. \*\*\*, në seksionin “A”, citohet: *“Banka jep tek kredimarrësi, sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë e të pranuar nga ai, një kredi në shumën 3.000.000 lekë. 3. Kredia do të përdoret nga kredimarrësi për blerje apartamenti”*.

13.50. Në seksionin “B”, pika 1, citohet: *“Kredia do të disbursohet me kërkesë të kredimarrësit në një shumë të vetme në llogarinë me nr. \*\*\*, të kredimarrësve Z. M. ose Shqiponja Milla, me qëllim për t’u transferuar në llogari të shitësit ‘\*\*\*’ sh.p.k. vetëm pasi kredimarrësi t’i ketë dhënë bankës prova të mjaftueshme që tregojnë se është kryer regjistrimi dhe kompletimi në mënyrën e duhur i mjeteve të sigurimit, të përshkruara në seksionin ‘C’ dhe janë lidhur të gjitha kontratat sipas kushteve të përcaktuara në seksionin ‘C’”*.

13.51. Në kontratën e kredisë është parashikuar që disbursimi i kredisë në shumën 3.000.000 lekë do të bëhet nga banka vetëm pasi kredimarrësi t’i ketë dhënë bankës prova të mjaftueshme që tregojnë se është kryer regjistrimi dhe kompletimi në mënyrën e duhur i mjeteve të sigurimit të përshkruara në seksionin “C” të kësaj kontrate dhe në vijim të këtij seksioni si mjet sigurimi është përshkruar pikërisht pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*.

13.52. Nga të gjitha faktet e prezantuara më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit arriti të shpjegojë dhe të provojë me provat që njeh legjislacioni procedural situatën faktike, si dhe të japë një shpjegim për rrethanat e pretenduara prej saj në aspektin logjik lidhur me përdorimin e kredisë bankare si burim për blerjen e apartamentit, sipas të cilës veprimet ishin kryer në kushtet e mungesës së pronësisë të subjektit e bashkëshortit të saj mbi pasuri të tjera të paluajtshme për t'u përdorur si garanci për kredinë e marrë.

13.53. Nga të dhënat e administruara përgjatë hetimit administrativ në drejtim të verifikimeve të burimit të krijimit të kësaj prone, Komisioni ka konkluduar se subjekti ka mundur të provojë se kjo pronë është financuar nga kredia e marrë me qëllim blerjen e këtij apartamenti.

13.54. Komisioni, në shqyrtim të deklarimeve të subjektit lidhur me ligjshmërinë dhe pasaktësitë e gjendjes *cash* të përdorur prej saj për këtë pasuri në vlerën 1.000 euro, ka vlerësuar se kjo gjendje *cash* nuk mund të merret në konsideratë në analizën financiare të krijimit të saj, por referuar vlerës mosmarrja në konsideratë e gjendjes *cash* si burim krijimi nuk ndikonte në aftësinë paguese të familjes së subjektit për krijimin e kësaj pasurie.

13.55. Konkluzioni i mësipërm është arritur duke mbajtur në konsideratë dhe sa ka rezultuar lidhur me të ardhurat e përfituara nga apartamenti i mëparshëm, vlerësuar si burim krijimi për këtë pasuri, për sa kohë provohet ligjshmëria e tyre. Lidhur me burimin e krijimit të apartamentit të mëparshëm, referuar vitit të krijimit të tij, 2001, shumë kohë përpara martesës dhe para fillimit të detyrës nga ana e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues ka vlerësuar se *nuk kanë një ndikim financiar në kuadër të procesit të rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit*.

13.56. Në lidhje me analizën financiare për vitin 2015, pas prapësimeve të subjektit të rivlerësimit në lidhje me shpenzimet e qëndrimit jashtë vendit, Komisioni, pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit, mbështetur edhe në dokumentacionin përkatës, vlerësoi të marrë në konsideratë, duke pasqyruar në analizën financiare:

- reduktim të shpenzimeve për udhëtime dhe qëndrime jashtë vendit për vitin 2015, në vlerën totale 338.121 lekë;
- reduktim të pagesës për ZVRPP-në dhe shërbimet e tjera në vlerën 162.720 lekë;
- kredinë bankare si burim krijimi të pasurisë së paluajtshme të krijuar në këtë vit.

13.57. Në konkluzion, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me burimet financiare të krijimit të kësaj pasurie të paluajtshme në vitin 2015, duke provuar mundësinë financiare të saj, që me të ardhura të ligjshme të mundësonte blerjen e kësaj pasurie të paluajtshme.

#### **14. Automjeti tip “\*\*\*\*”, në përdorim**

14.1. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaron: “*Automjet tip ‘\*\*\*\*’ marka ‘\*\*\*\*’, ngjyrë e zezë, me targa \*\*\*\*, dhënë në përdorim bashkëshortit Z. M. nga shtetasi E. M. H., me prokurë të posaçme nr. \*\*\*\*, datë 14.1.2017. Mjeti në fjalë është dhënë në përdorim për shkak të marrëdhënieve me bashkëshortin dhe pamundësisë së bashkëshortit për të blerë automjet të ri*”.

14.2. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*: (i) prokurë të posaçme nr. \*\*\*\*, datë 14.1.2017, për ta përdorur këtë automjet në Shqipëri dhe jashtë saj, për t'u përgjigjur për të gjitha detyrimet financiare në lidhje me çdo lloj takse dhe çdolloj gjobe që mund të marrë; (ii)

certifikatë pronësie të automjetit tip “\*\*\*\*”, me targa \*\*\*, në emër të shtetasit E. H.; (iii) vërtetim datë 30.12.2016, e DRSHTRR-së Shkodër, me të cilin vërtetohet se automjeti tip “\*\*\*\*” me targa \*\*\* është hequr nga qarkullimi përfundimisht në datën 30.12.2016, për arsye jashtë përdorimi.

14.3. DPSHTRR-ja ka vendosur në dispozicion kopje të dosjes së automjetit, nga ku rezulton se: (i) me kontratën e shitblerjes datë 14.9.2016, shtetasi E. H. ka blerë automjetin tip “\*\*\*\*”, viti 2004, me çmim 1.600 euro; (ii) sipas zhdoganimit datë 28.9.2016, vlera e automjetit është deklaruar 1.600 euro; (iii) shtetasi E. H. është pajisur me certifikatë pronësie të mjetit rrugor në datën 4.10.2016.

14.4. Të dhënat e nxjerra nga sistemi TIMS konfirmojnë se subjekti i rivlerësimit dhe familja e saj kanë kaluar kufirin shqiptar me automjetin 8 herë në periudhën 15.10.2016 – 9.9.2017, ndërkohë pronari nuk rezulton se e ka përdorur këtë automjet në udhëtime jashtë vendit.

14.5. Gjatë hetimit administrativ, në pyetësorin standard, subjekti deklaron se me shtetasin E. H. ka pasur marrëdhënie shoqërore, ndaj mjeti i është dhënë pa pagesë për përdorim.

14.6. Në vijim, Komisioni i është drejtuar me kërkesë për verifikimin e konfliktit të mundshëm të interesit Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër/Pukë lidhur me pronarin e automjetit që ka marrë në përdorim bashkëshorti i subjektit dhe nga përgjigjet nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë për subjektin e rivlerësimit.

14.7. Referuar dokumentacionit të depozituar, vlera e blerjes së mjetit në datën 14.9.2016 rezulton 1.600 euro. Me deklaratën doganore datë 28.9.2016, janë shlyer detyrimet doganore për shumën 52.256 lekë, në total 272.288 lekë. Në bazë të formularit të deklarimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitin 2016, shtetasi E. H. ka realizuar të ardhura në shumën 828.976 lekë dhe fitim në shumën 204.176 lekë. Sa më sipër, nuk mund të arrihet në rezultat në lidhje me mundësinë financiare të pronarit të mjetit për blerjen dhe zhdoganimin e tij, pasi mungojnë të dhënat për të ardhurat dhe/ose pasuri të krijuara nga ky shtetas deri në kohën e blerjes së automjetit.

14.8. Komisioni ka kërkuar nga subjekti i rivlerësimit të japë shpjegime për të provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm që nuk ndodhet në situatën e parashikuar nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, lidhur me këtë automjet.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

14.9. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: *“Në asnjë moment nga ana ime nuk është tentuar të fshihet përdorimi i këtij mjeti nga bashkëshorti im Z. M. dhe familja. Pronari formal i këtij mjeti ka qenë edhe pronari faktik i tij dhe fakti që ai nuk e ka përdorur këtë mjet në udhëtimet e tij jashtë Shqipërisë nuk mund të çojë apriori në konkluzionin që ky mjet nuk ka qenë në pronësi dhe përdorim të tij deri në momentin që e ka shitur.*

*Shtetasi në fjalë ka pasur aktivitet tregtar të licencuar në momentin që mua si subjekt më është dashur të jap shpjegime lidhur me këtë mjet dhe për të qenë sa më bashkëpunuese lidhur me këtë hetim kam administruar të dhënat e aktivitetit të tij tregtar dhe të ardhurat/fitimin e tij, nga i cili rezulton se ai ka pasur mundësi të blejë mjetin në muajin shtator në vlerën 1.600 euro dhe të paguajë detyrimet doganore përkatëse”.*

## **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

14.10. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet e saj dhe përfaqësueses ligjore në seancën dëgjimore – arsyeton se:

14.11. Referuar situatës faktike të përdorimit të automjetit prej subjektit të rivlerësimit, provuar gjatë hetimit në Komision, subjekti ka përmbushur detyrimin të deklaronte këtë marrëdhënie, në zbatim të përcaktimeve të pikës 11 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit përcaktohej se: *“Pasuri janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, ‘Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë’, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit”*.

14.12. Për sa më sipër, subjekti ka bërë deklaratim të saktë në deklaratën *Vetting*, duke e deklaruar përdorimin e këtij mjetei prej saj. Për sa rezultoi se nga subjekti u provua mundësia financiare për pronarin e automjetit, lidhur me burimin e ligjshëm të kësaj pasurie, rrethanat e konstatuara gjatë hetimit administrativ janë të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se ky automjet nuk është një pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimeve të pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “c” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

### **15. Hua në shumën 1.000.000 lekë**

15.1. Në deklaratën *Vetting*, në rubrikën “të dhëna konfidenciale”, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *“Hua në shumën 1.000.000 lekë, marrë shtetas E. L. në datën 7.3.2016. Qëllimi i huas është mbulimi i pjesshëm i shpenzimeve të kryera për mjekimin e bashkëshortit Z. M., aksidentuar në datën 8.1.2016. Deklarata e huas është autentifikuar para noterit”*.

15.2. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*: (i) deklaratë datë 7.3.2016, ku shtetasja E. L. deklaroi se i jep hua shtetasve Z. dhe Shqiponja Milla shumën 1.000.000 lekë, për shkak të problemeve shëndetësore që ka pasur z. Z. M. nga aksidenti në fillim të vitit; (ii) autentifikim nënshkrimi; dhe (iii) llogarinë e “Raiffeisen Bank”.

15.3. Në deklarimin periodik vjetor të vitit 2016, dorëzuar në datën 20.3.2017, subjekti në rubrikën “shpenzime të deklarueshme” deklaroi *shpenzim për mjekimin e bashkëshortit pranë spitalit “\*\*\*”, aksidentuar në datën 8.1.2016, operacioni i kryer pranë këtij spitali në datën 9.1.2016, në vlerën 915.325 lekë, duke mos deklaruar burim për shpenzimet*.

15.4. Subjekti, në pyetësorin standard në lidhje me këtë hua, deklaroi se: *“Në vitin 2016 (7.3.2016) kam marrë borxh vlerën 1.000.000 lekë. Borxhi është marrë nga shtetasja E. L., mike e përbashkët e familjes prej disa vitesh. Huaja është marrë pa afat dhe pa kushte shlyerjeje. Detyrimi në fjalë është shlyer tërësisht në 2017-ën”*.

15.5. Komisioni, duke qenë se huaja është dhënë në datën 7.3.2016, pra 2 muaj më pas nga shpenzimet e deklaruara, vlerëson të mos marrë në konsideratë huan e dhënë nga shtetasja E. L., që ka shërbyer si burim për mbulimin e shpenzimeve në periudhën janar – shkurt 2016.

15.6. Huaja/ndihma e përfituar nga të afërmit e tyre, në shumën 650.000 lekë, e padeklaruar në DPV/2016, nuk u përfshi si burim për shpenzimet e kryera.

15.7. Ndërsa, për sa i përket likuiditeteve *cash* në shumën 200.000 lekë, Komisioni vlerësoi të mos merren në konsideratë, bazuar në rezultatet e analizës paraprake financiare.

15.8. Mbështetur në dokumentacioni e disponuar, si dhe përgjigjet e subjektit, Komisioni kreu një analizë paraprake financiare për të evidentuar mundësinë e subjektit dhe personit të lidhur për të paguar shpenzimet shëndetësore në vlerën 915.325 lekë deri në datën 22.2.2016 dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për periudhën 1.1.2016 – 22.2.2016, nga e cila duket se subjekti nuk ka arritur të dokumentojë burimin e të ardhurave për shlyerjen e shumës 915.325 lekë deri në datën 22.2.2016.

**15.9. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e sa duket se:**

- Huaja që subjekti i ka marrë shtetasës E. L. nuk mund të përfshihet si burim për shpenzimet mjekësore, pasi është dhënë 2 muaj pas kryerjes së shpenzimeve të deklaruara.

- Ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin financiar për shpenzimet mjekësore, sipas faturave të depozituara në vlerën 915.325 lekë deri në datën 22.2.2016 dhe mungesë të burimeve financiare për vitin financiar 2016.

**Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

15.10. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: *“Nga ana ime në asnjë rast nuk është ndryshuar deklarimi, për sa i përket burimit për mbulimin e shpenzimeve mjekësore. Përkundrazi, në çdo deklaram të bërë, si DPV/2016, ashtu edhe në deklaratën Vetting, kam thënë qartazi se shuma 1.000.000 e marrë hua në datën 7.3.2016 nga shtetasja E. L. është përdorur për mbulimin e pjesëshëm të shpenzimeve të mjekimit të bashkëshortit të aksidentuar në datën 8.1.2016.*

*Në atë situatë në të cilën jam gjendur në kohën në fjalë, me një gjendje të ngarkuar psikologjike, kam menduar vetëm për shëndetin e bashkëshortit dhe as e kam menduar përpilimin menjëherë të deklaratave noteriale. Pas rikuperimit disi të bashkëshortit, afro pas dy muajsh, kemi bërë llogaritë e lekëve që kishim marrë hua nga prindërit dhe të afërmit dhe kemi marrë hua shumën 1.000.000 lekë nga shtetasja E. L., duke likuiduar menjëherë nga kjo hua një pjesë të borxheve që kisha marrë unë për shpenzimet spitalore pas aksidentit nga prindërit dhe djali i shaxhait të bashkëshortit”.*

**Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

15.11. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – arsyetoni se:

15.12. Shpjegimet e subjektit mbi ndihmën nga prindërit dhe të afërmit për mbulimin e shpenzimeve mjekësore për bashkëshortin, të cilat subjekti i ka shlyer me huan më afatgjatë

nga shtetasja E. L., ishin bindëse, për sa i përket arsyes së marrjes së tyre dhe mosdeklarimi i tyre në deklaratën periodike, pasi ishin shlyer brenda vitit nga huaja e marrë nga kjo shtetase, ndaj dhe referuar sa më sipër, kjo hua dhe për të cilën u provua burimi i ligjshëm i krijimit nga ana e huadhënëses u konsiderua në analizën financiare përfundimtare lidhur me këto shpenzime.

15.13. Sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime financiare të ligjshme për të paguar shpenzimet shëndetësore në vlerën 915.325 lekë, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara për periudhën 1.1.2016 – 22.2.2016.

15.14. Në lidhje me analizën financiare për vitin 2016, pas prapësimeve të subjektit të rivlerësimit në lidhje me shpenzimet e qëndrimit jashtë vendit, Komisioni, pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit mbështetur edhe në dokumentacionin përkatës, vlerësoi të marrë në konsideratë, duke pasqyruar në analizën financiare:

- shpenzime të qëndrimit jashtë vendit të fëmijës së subjektit dhe personit të lidhur (bashkëshortit), të deklaruara/dokumentuara të mbuluara nga të tretë, u rillogaritën shpenzimet e qëndrimit prej 5 euro/ditë, të cilat rezultojnë në vlerën 417.049 lekë;
- shumën 1.000.000, marrë hua në datën 7.3.2016 nga shtetasja E. L., për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të bashkëshortit.

15.15. Në konkluzion, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave për kryerjen e shpenzimeve shëndetësore për vitin 2016 dhe të kundërtën e barrës së provës lidhur me pamundësinë financiare gjatë vitit kalendarik 2016.

## **16. Analiza e treguesve financiarë**

16.1. Nga analiza e përgjithshme e treguesve financiarë, kryer nga Komisioni, për periudhën nga fillimi i detyrës deri në datën 31.12.2016, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, si dhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur (bashkëshortit), përveç sa pasqyruar/analizuar më lart lidhur me pamundësinë financiare në vitet 2015 - 2016, përkatësisht për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve, ka rezultuar gjithashtu se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti nuk kanë pasur mundësi financiare për krijimin e pasurive për vitin e mbyllur 2014, i cili ka rezultuar me balancë negative.

16.2. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit lidhur me pamundësinë financiare të vitit 2014.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

16.3. Pas kalimit të barrës së provës subjekti, ndër të tjera, ka prapësuar se për vitin 2014:

*“Kemi blerë automjetet ‘\*\*\*’ me targa \*\*\*, me çmim 250.000 lekë, me burim të ardhurash nga kursimet që kemi pasur cash, duke mbetur gjendja në fund të vitit 2014 shuma 500.000 lekë, deklaruar edhe në procesverbalin e datës 22.2.2016 në ILDKPKI.*

*Në këtë vit nuk kam shtuar gjendjen e likuiditeteve cash me 450.000 lekë, siç e ka llogaritur Komisioni, por është pakësuar gjendja cash e likuiditeteve me 250.000 lekë (pjesë nga gjendja cash e shumës së kredisë).*

*Në shpenzimet e transportit dhe qëndrimet jashtë vendit nga Komisioni nuk është marrë në konsideratë që në periudhën 29.12.2013 – 4.1.2014 kemi qenë për vizitë te motra e bashkëshortit, prandaj shpenzimet e qëndrimit duhet të më llogariteshin me 5 euro dita, referuar praktikës së konsoliduar të Kolegjit, dhe jo 50 euro. Gjithashtu, biletat e udhëtimit janë blerë në vitin 2013 dhe nuk duhen llogaritur si shpenzim në vitin 2014.*

*Të ardhura neto si prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Pukë (të nxjerra nga transaksionet bankare) kanë qenë 513.135 leke dhe jo 446.026 lekë të llogaritur nga Komisioni, plus 67.109 lekë”.*

16.4. Në mbështetje të pretendimeve të saj, subjekti i rivlerësimit ka depozituar edhe deklaratën noteriale datë 24.2.2023, të shtetases E. K. (rezidente në Itali nga viti 2000), nëpërmjet së cilës kjo e fundit ka deklaruar, ndër të tjera, se ka mbajtur në shtëpinë e saj mbesën S. M. me të gjitha shpenzimet e nevojshme për qëndrim dhe ushqim në datën 7.7.2016 deri më 27.7.2016 dhe në datën 9.8.2016 deri më 13.9.2016; si dhe janë strehuar familjarisht në shtëpinë e saj, duke mbuluar të gjitha shpenzimet për ushqim, strehim dhe transport në vitin 2013, për pushimet e Vitit të Ri në harkun kohor 29.12.2013 – 4.1.2014; në muajin gusht 2015, rreth datës 11.8.2015 deri më 18.8.2015, që kanë ardhur familjarisht për pushime verore.

#### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

16.5. Komisioni, bazuar në dokumentacionin e disponuar, shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet e subjektit dhe përfaqësueses ligjore në seancë, arsyeton se:

16.6. Për vitin 2014, referuar deklarimeve pranë ILDKPKI-së, qoftë në deklarinim për herë të parë, ashtu edhe në deklarinim të interesave privatë periodikë vjetorë, ka deklaruar këto gjendje shtesa/pakësime të likuiditeteve *cash* në banesë: (i) në deklarinim të interesave privatë para fillimit të detyrës në datën 5.11.2008, subjekti ka deklaruar shumën 2.000.000 lekë në gjendje *cash*; (ii) në deklaratën e interesave privatë periodikë për vitin 2011, në seksionin “ndryshimet e interesave privatë pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme” ka deklaruar *kursime nga paga si prokurore në shumën 50.000 lekë*; (iii) në përgjigjet e dhëna në ILDKPKI në vitin 2016 ka deklaruar se *gjendja cash në datën 31.12.2014 në banesë rezulton 500.000 lekë*.

16.7. Sa më sipër, pasi është analizuar ligjshmëria e burimit të deklaruar për kursimin e gjendjes *cash* në datën 5.11.2008 dhe rezultoi me një pamundësi financiare, Komisioni ka vlerësuar se shtesa e likuiditeteve *cash* në vitin 2014, në krahasim me periudhën paraardhëse, të jetë në vlerën 450.000 lekë [(500.000 lekë të deklaruara si gjendje *cash* në datën 31.12.2014) - (50.000 lekë të deklaruara si kursime *cash* në DIPPV/2011)].

16.8. Për sa i përket gjendjes *cash* në vitin 2009, të pretenduar në shumën 500.000 lekë, në përgjigje të pyetësorit me burim kredinë e marrë nga personi i lidhur në F. B., Komisioni vlerësoi të mos e marrë në konsideratë në analizën financiare, pasi subjekti nuk ka deklaruar në DIPPV/2009 shtesën e pretenduar të likuiditeteve *cash* në vlerën 500.000 lekë, në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, neni 4, germa “d”.

16.9. Saktësia dhe mjaftueshmëria e deklarimeve për një subjekt deklarimi vlerësohet vetëm përmes deklarimeve të sakta dhe të plota. Trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për mënyrën e deklarimeve të kursimeve është i pambështetur në prova dhe në ligj.

16.10. Saktësia dhe mjaftueshmëria e deklarimeve për një subjekt deklarimi matet vetëm përmes deklarimeve të sakta dhe të plota. Detyrimi ligjor i subjektit të rivlerësimit për të deklaruar pasuritë ka lindur që nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, përcaktimet e të cilit kanë qenë të qarta në këtë drejtim lidhur me deklarin e çdo pasurie, përfshirë edhe likuiditetet *cash*, si dhe shtesat dhe ndryshimet në to.

16.11. Për rrjedhojë, trupi gjykues kursimet në formën e likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar, shtesat dhe pakësimet i llogariti sipas deklarimeve të subjektit dhe personave të lidhur me të në deklaratat periodike vjetore.

16.12. Në lidhje me pretendimet për shpenzimet e qëndrimit dhe transportit jashtë vendit, që janë mbuluar nga të tretë (motra e bashkëshortit), Komisioni kreu reduktimet e vlerave për periudhën 29.12.2013 – 4.1.2014, në raport me kohën e udhëtimit dhe në mbështetje me metodologjinë e Kolegjit.

16.13. Në lidhje me të ardhurat *neto* nga paga e subjektit për vitin 2014, Komisioni vlerësoi që të merrej në konsideratë shuma 513.135 lekë, e kredituar në llogarinë bankare të pagës. Pas reflektimit të sa më sipërshtetuar, analiza financiare për vitin 2014 rezultoi si vijon:

<b>Analiza financiare për periudhën 1.1.2014 – 31.12.2014</b>	
<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera në lekë</b>
Të ardhura <i>neto</i> si prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Pukë	513.135
Të ardhura <i>neto</i> si prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër	532.583
Të ardhura nga punësimi, personi i lidhur (bashkëshorti)	30.806
<b>Total të ardhura/të hyra financiare</b>	<b>1.076.524</b>
Shpenzime transporti dhe qëndrimi jashtë vendit	476.476
Shpenzime për regjistrim/sigurim automjeti sipas AMF-së	16.000
Shpenzime shkollimi	119.000
Shpenzime minimale për konsum INSTAT, për periudhën (3 persona)	659.994
<b>Total shpenzime/të dala financiare</b>	<b>1.271.470</b>
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> deklaruar gj. fillim - gj. fund periudhe	-450.000
Ndryshim mj. monetare bankë dokumentuar gj. fillim - gj. fund periudhe	-42.693
<b>Mjete monetare të disponueshme (1)</b>	<b>-687.639</b>
Autoveturë “***”, blerë në datën 26.6.2014	250.000
<b>Total pasuri</b>	<b>250.000</b>
<b>Detyrime financiare</b>	<b>0</b>
<b>Pasuri <i>neto</i> (2)</b>	<b>250.000</b>
<b>Balanca e fondeve (1-2)</b>	<b>-937.639</b>

16.14. Sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë arritur të dokumentojnë burimin e të ardhurave për blerje pasurie, shtesë në likuiditet të deklaruar dhe kryerje të shpenzimeve për vitin 2014, duke rezultuar me një balancë negative për vitin 2014 në vlerën 937.639 lekë.



16.15. Trupi gjykues vlerëson se mungesa e likuiditetit për vitin financiar 2014, në shumën - 937.639 lekë, nuk është në masën që cenon besimin e publikut dhe mungesa e këtij likuiditeti në këtë masë nuk përbën arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

### **Konkluzion i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë**

17. Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë, nuk rezulton të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi të saj.

17.1. Trupi gjykues çmon se mungesa e likuiditeteve gjatë vitit 2014 në vlerën -937.639 lekë nuk është në masën që të përbëjë shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

17.2. Sipas vlerësimit të trupit gjykues, referuar kuadrit kushtetues dhe ligjor të zbatueshëm për vlerësimin e kriterit të pasurisë, pasaktësitë e reflektuara në dokumentacionin ligjor të përfitimit të pasurisë apartament janë rrethana që në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, nuk mund të ndryshojnë përfundimin e arritur se subjekti i rivlerësimit Shqiponja Milla ka arritur një nivel të besueshëm të kriterit të vlerësimit të pasurisë.

### **B. KONTROLLI I FIGURËS**

18. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, si institucioni kompetent për kontrollin e figurës, verifikimit të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, si dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka paraqitur pranë Komisionit raportin fillestar nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, i deklasifikuar plotësisht me konstatimin për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

18.1. DSIK-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.2.2023, ka dërguar njoftimin për deklasifikimin pjesërisht të raportit të përditësuar për kontrollin e figurës, të përcjellë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.6.2021, i cili informon se për subjektin e rivlerësimit Shqiponja N. Milla disponohen të dhëna që sinjalizojnë shpërdorimin e detyrës, duke favorizuar palët e interesuara dhe se konkluzioni të mbetet në vlerësimin e Komisionit nën dritën e informacioneve të tjera që mund të disponohen si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ që kryhet ndaj subjektit të rivlerësimit.

18.2. Pas aksesit nga trupi gjykues i Komisionit, së bashku me vëzhguesen ndërkombëtare, në informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, që i përket praktikës së verifikimit të kryer nga organet ligjzbatuese për kriterin e kontrollit të figurës për subjektin e rivlerësimit, me qëllim verifikimin e burimeve të informacionit, nuk u konstatuan *indicie* për thellimin e hetimit lidhur me komponentin e figurës për subjektin e rivlerësimit.

18.3. Në përfundim të procesit të rivlerësimit të figurës, bazuar në nenin DH të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pas hetimit të kryer për këtë kriter, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi

formularin e deklaratimit për kontrollin e figurës dhe nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

18.4. Për sa më sipër, Komisioni ka arritur në konkluzionin se konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Shqiponja Milla.

### **Konkluzion për kontrollin e figurës**

19. Komisioni, pas hetimit të kryer për këtë kriter, bazuar në nenin DH të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaratimit për kontrollin e figurës dhe nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

19.1. Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Shqiponja Milla ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

## **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

20. Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit është kryer në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kreu VI, nenet 40 e vijues i tij, mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nga Prokuroria e Përgjithshme, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit.

21. Lidhur me tri dosjet e përzgjedhura nga subjekti nuk janë konstatuar problematika, ndërsa gjetjet nga vëzhgimi i disa prej dosjeve të shortuara përshkruhen si vijon:

**21.1. Dosja nr. 1** – kallëzimi penal nr. \*\*\* i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, vendosur mosfillimi i procedimit penal datë 1.12.2014. Në datën 26.9.2014 oficerët e policisë gjyqësore janë njoftuar për dëmtim prone në katin e katërt, në një pallat në vendin e quajtur “\*\*\*”. Në datën 2.10.2014 është regjistruar materiali kallëzues referuar nga Komisariati i Policisë Shkodër, sipas të cilit shtetasi F. B. ka pretenduar se shtetasi N. M. linte qëllimisht të hapur çezmën, me qëllim që të dëmtonte banesën e kallëzuesit. Shtetasi N. M. vuante nga probleme shëndetësore mendore dhe nuk është bërë e mundur të merreshin deklaratime në lidhje me faktin. Mbi bazën e akteve të administruara në fashikull, prokurorja ka konkluduar që fakti i ndodhur nuk parashikohej nga ligji si vepër penale, pasi konsumimi i veprës penale “shkatërrim prone”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal, kërkonte domosdoshmërisht ekzistencën e dy elementeve thelbësore: a) kryerjen e veprimeve me dashje; dhe b) ardhjen e pasojës jo të lehtë. Prokurorja ka arsyetuar se në rastin konkret, shtetasi N. M. kishte probleme të theksuara mendore dhe, gjithashtu, dëmi i shkaktuar nuk kategorizohej si pasojë jo e lehtë, në kuptim të nenit 150 të Kodit Penal. Subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 290/1, germa “ç” dhe nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal në datën 1.12.2014 dhe rezulton se vendimi i mosfillimit të procedimit penal i është njoftuar palëve dhe nuk është ankimuar.

Dokumenti ligjor “vendim mosfillimi” është i strukturuar në pjesën hyrëse, përshkruese-arsyetuese dhe dispozitivin.

21.1.1. Nga analizimi i materialeve në dosje konstatohet se nga momenti i regjistrimit të materialit kallëzues deri në momentin e marrjes së vendimit të mosfillimit të procedimit penal në datën 1.12.2014 ka kaluar një periudhë prej rreth 2 muajsh. Nga të dhënat e pasqyruara si më sipër, vendimi për mosfillimin e procedimit penal është marrë jashtë afatit 30-ditor, të parashikuar në udhëzimin nr. 3, datë 19.6.2012, “Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, ‘Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale’, i ndryshuar”, të Prokurorit të Përgjithshëm.

**Sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime lidhur me këtë konstatim.**

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës**

21.1.2. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka parashtruar se: *“Lidhur me kallëzimin penal nr. \*\*\* dhe konstatimin e Komisionit që vendimi për mosfillimin është marrë pas kalimit të afatit 2-mujor të përcaktuar në udhëzimin nr. 3, datë 19.6.2012, ‘Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, ‘Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale’, i ndryshuar’, të Prokurorit të Përgjithshëm, sqaroj se një vonesë e tillë ka ardhur për shkak të ngarkesës shumë të madhe në punë gjatë këtij viti. Gjatë kësaj periudhe, nga muaji shtator 2014 deri në datën 3.12.2014 janë mosfilluar 72 materiale kallëzuese dhe ka qenë e pamundur fizikisht marrja e vendimit brenda afatit të përcaktuar në këtë udhëzim”.*

21.1.3. Subjekti i rivlerësimit paraqiti në cilësinë e provës shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, që përmban bashkëlidhur ngarkesën e punës për vitin 2014 - 2015.

#### **Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

21.1.4. Komisioni, pasi mori në analizë shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, arrin në përfundimin se subjekti duhet të kishte treguar kujdesin e duhur në lidhje me respektimin e afatit të parashikuar në udhëzimin nr. 3, datë 19.6.2012, “Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, ‘Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale’”, i ndryshuar, por, pavarësisht sa më sipër, Komisioni nuk e konsideron me ndikim negativ në lidhje me vlerësimin profesional të subjektit.

**21.2. Dosja nr. 2** – procedimi penal nr. \*\*\* i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, datë regjistrimi 7.10.2015, regjistruar për veprën penale “dhunë në familje”, parashikuar nga neni 130/a/1 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasve N. P. dhe djali i tij K. P. Prokurorja e çështjes ka trajtuar në arsyetimin e saj ligjor normat e ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, për dhunën në familje, si dhe përcaktimet e Konventës së Këshillit të Evropës, e nënshkruar nga Republika e Shqipërisë, ku janë detajuar nocionet e dhunës në familje dhe kategoria e personave që përfshihen në këto norma ligjore. Duke iu referuar fakteve dhe rrethanave që kanë rezultuar nga hetimi, prokurorja e çështjes ka konkluduar që veprimet e kryera nga shtetasi K. P., 15 vjeç, duke goditur babain e tij me shkop, ka qenë në kushtet e mbrojtjes së nevojshme ndaj dhunës fizike që babai mund të ushtronte ndaj nënës apo pjesëtarëve të tjerë të familjes dhe, për rrjedhojë, nuk mbante përgjegjësi për veprimin e kryer. Duke vlerësuar që veprimet e kryera nga shtetasi K. P. ishin në kushtet e parashikuara nga neni 19 i Kodit Penal “Mbrojtja e nevojshme”, bazuar në nenin 328/1, germat “b” dhe “ç” dhe nenin

329/1 të Kodit të Procedurës Penale, në datën 15.2.2016, prokurorja, subjekt rivlerësimi, ka vendosur pushimin e çështjes penale nr. \*\*\*. Nga aktet e administruara nuk rezulton që ky vendim të jetë ankimuar nga palët.

21.2.1. Nga analizimi i dosjes u konstatua se në fashikullin penal nuk administrohet aktekspertimi mjekoligjor i shtetasit N. P., pavarësisht se oficeri i policisë gjyqësore në datën 4.7.2015 ka vendosur për kryerjen e ekspertimit mjekoligjor për këtë shtetas. Nëpërmjet mjetit procedural të ekspertimit synohet vërtetimi dhe sqarimi i të dhënave provuese për përcaktimin e ngjarjeve dhe vërtetimin e fakteve.

**Sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime lidhur me këtë konstatim.**

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës**

21.2.2. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka parashtruar se: *“Në rastin konkret nuk ka pasur asnjë dyshim rreth ngjarjes apo fakteve. Përkundrazi, ka rezultuar e provuar që shtetasi N. P. ishte personi shkaktar i konfliktit që ka pasur në familje ditën e ngjarjes. Ndërkohë, lidhur me aktekspertimin, pavarësisht se nga oficeri është marrë vendim ekspertimi, gjatë hetimeve ka rezultuar se i dëmtuari nuk është paraqitur te mjeku ligjor për ekzaminimin e dëmtimeve të tij, rrjedhimisht nga eksperti mjekoligjor nuk është përpiluar një akt i tillë dhe nuk ka pasur se si të administrohet një kopje e tij. Pavarësisht sa më lart, nga ana ime është verifikuar shkalla e dëmtimeve që mund të kishte marrë shtetasi në fjalë, duke i kërkuar informacion Qendrës Shëndetësore, ku është marrë informacion që është mjekuar ky shtetas. Fakt ky i provuar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.12.2015, të qendrës shëndetësore \*\*\*, nga ku ka rezultuar se në datën 4.7.2015, pranë kësaj qendre është paraqitur shtetasi N. P., i datëlindjes 15.1.1974, me gjendje hipotensive, contusion dhe plagë në pjesën frontale për të cilën i është bërë saturimi. Këto dëmtime nuk paraqesin rrezikshmëri për gjendjen e tij”.*

### **Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

21.2.3. Komisioni, pasi mori në analizë shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe vlerësoi provat në dosjen penale, i gjen këto shpjegime të mjaftueshme dhe bindëse. Komisioni mban në konsideratë edhe faktin se vendimi i pushimit nuk është ankimuar në gjykatë nga palët.

## **ANALIZA E GJETJEVE**

### **22. Aftësitë profesionale**

#### *a. Njohuritë ligjore*

Rezulton se prokurorja Shqiponja Milla është vlerësuar “shumë mirë” për vitet 2014, 2015 dhe 2016, dokumentuar me aktet e përpiluara nga Prokurori i Përgjithshëm.

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti i rivlerësimit identifikon normën ligjore të zbatueshme, duke arsyetuar për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret.

#### *b. Arsyetimi ligjor*

Rezulton se prokurorja Shqiponja Milla është vlerësuar “shumë mirë” për vitet 2014, 2015 dhe 2016, dokumentuar me aktet e përpiluara nga Prokurori i Përgjithshëm.

Aktet e përpiluara paraqiten të qarta e të kuptueshme dhe respektohen rregullat e drejtshkrimit. Bazuar në aktet e dorëzuara dhe në dosjet e shortuara, konstatohet se subjekti i rivlerësimit Shqiponja Milla shfaq aftësi në pasqyrimin e rrethanave të faktit, analizën e provave dhe ballafaqimin e tyre me bazën ligjore të aplikueshme.

### **23. Aftësitë organizative**

#### *a. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë*

Rezulton se prokurorja Shqiponja Milla është vlerësuar “shumë mirë” për vitet 2014, 2015 dhe 2016, dokumentuar me aktet e përpiluara nga Prokurori i Përgjithshëm.

Duke iu referuar vërtetimit nr. \*\*\*, datë 12.10.2020 dhe listës së statistikave, vënë në dispozicion të Komisionit në procedurën e shortimit të dosjeve të datës 13.10.2020, konstatohet se janë 460 çështje të trajtuara nga subjekti i rivlerësimit të marra në shqyrtim për shortim. Duke pasur parasysh statistikën e ngarkesës së punës, si dhe natyrën e çështjeve që trajtohen në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, konstatohet se prokurorja Shqiponja Milla është përballur me një ngarkesë të konsiderueshme pune, referuar natyrës dhe shumëllojshmërisë së veprimeve hetimore.

Nga gjetjet në dokumentet ligjore të përzgjedhura në shortin e zhvilluar në datën 13.10.2020, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për përzgjedhjen e 5 dokumenteve ligjore për periudhën e vlerësimit tetor 2013 – tetor 2016, rezulton se afatet kohore të zgjidhjes së praktikave që kanë lidhje me dokumentet ligjore të përzgjedhura me short janë të arsyeshme në raport me natyrën dhe kompleksitetin e praktikave përkatëse.

#### *b. Aftësia për të kryer procedurat hetimore*

Rezulton se prokurorja Shqiponja Milla është vlerësuar “shumë mirë” për vitet 2014, 2015 dhe 2016, dokumentuar me aktet e përpiluara nga Prokurori i Përgjithshëm.

Subjekti i rivlerësimit, në rastin e vendimmarrjes mbi mosfillimin e procedimit penal, rezulton të ketë argumentuar mungesën e elementeve të veprës penale. Në procedimet penale, për të cilat është vendosur pushimi i hetimeve, është realizuar drejtimi i hetimeve të kryera nga policia gjyqësore, duke argumentuar vendimmarrjen për pushimin e procedimeve penale. Subjekti i rivlerësimit ka shfaqur aftësitë e nevojshme edhe mbi kontrollin e hetimeve të kryera nga policia gjyqësore për të mbështetur akuzën në çështjet me të pandehur të dërguar për gjykim.

#### *c. Aftësia për të administruar dosjet*

Rezulton se prokurorja Shqiponja Milla është vlerësuar “shumë mirë” për vitet 2014, 2015 dhe 2016, dokumentuar me aktet e përpiluara nga Prokurori i Përgjithshëm.

Nga vëzhgimi i akteve të dorëzuara nga subjekti dhe 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, prokurorja Shqiponja Milla, në ushtrim të kompetencave ligjore ka aftësi për të administruar dosjet.

### **24. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

#### *a. Etika në punë*

Rezulton se prokurorja Shqiponja Milla është vlerësuar “shumë mirë” për vitet 2014, 2015 dhe 2016, dokumentuar me aktet e përpiluara nga Prokurori i Përgjithshëm.

### *b. Integriteti*

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokurore Shqiponja Milla, dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

### *c. Paanësia*

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Shqiponja Milla. Në asnjë prej dokumenteve dhe dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Gjithashtu, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

## **25. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

### *a. Aftësitë e komunikimit*

Rezulton se prokurorja Shqiponja Milla është vlerësuar “shumë mirë” për vitet 2014, 2015 dhe 2016, dokumentuar me aktet e përpiluara nga Prokurori i Përgjithshëm. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk rezultojnë të dhëna që flasin për mënyrën e komunikimit ndërpersonal të subjektit me pjesëmarrësit në proces.

### *b. Aftësia për të bashkëpunuar*

Rezulton se prokurorja Shqiponja Milla është vlerësuar “shumë mirë” për vitet 2014, 2015 dhe 2016, dokumentuar me aktet e përpiluara nga Prokurori i Përgjithshëm.

### *c. Gatishmëria për t’u angazhuar*

Ka marrë pjesë në aktivitete profesionale, si për ngritjen e nivelit profesional, ashtu edhe në shkëmbimin e eksperiencave apo përfaqësimin e institucionit brenda dhe jashtë vendit, duke u vlerësuar me certifikatat përkatëse.

## **Konkluzion për vlerësimin e aftësive profesionale**

26. Trupi gjykues konkludon se në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

## **DENONCIMET**

27. Bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni ka analizuar 12 denoncime për subjektin e rivlerësimit, si vijon:

### **27.1. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 23.1.2019, i shtetasit B. R.**

Objekti i denoncimit është verifikimi i ligjshmërisë së veprimeve hetimore dhe shkeljeve të kryera nga ana e subjektit të rivlerësimit në hetimin që i përket procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2018. Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer: (i) veprime hetimore të plota; si dhe (ii) nuk ka kryer asnjë veprim kundër shtetasit të akuzuar dhe ka zvarritur procesin,

me qëllim që shtetasi i akuzuar të përfitojë nga amnistia. Denoncuesi ka bashkëlidhur përkatësisht: (i) kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq të hetimit të procedimit penal nr. \*\*\*, filluar në datën 4.6.2018; dhe (ii) urdhër për regjistrimin e procedimit dhe emrit të personit, të cilit i atribuohet vepra penale për procedimin penal nr. \*\*\*, viti 2018.

Komisioni i kërkoi Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dosjen e fashikullit përkatës për procedimin penal nr. \*\*\*, datë 4.6.2018, nga analizimi i së cilës i kërkoi subjektit të japë shpjegime në lidhje me: (i) mungesën e arsytimit ligjor mbi ndryshimin e cilësimit të veprës penale ndaj shtetasit B. R. nga ajo e referuar në kërkesën për vleftësimin e masës “arrest me burg”, “përkrahje e autorit të krimit” në “falsifikim të vulave, të stampave ose të formularëve”; (ii) mungesën e paraqitjes së kërkesës për marrje të masës së sigurisë në gjykatë kundrejt shtetasit Gj. M., duke mos marrë në konsideratë rrezikshmërinë e personit nën hetim.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Subjekti, pasi ka shpjeguar lidhur me ndryshimin e cilësimit të veprës penale ndaj shtetasit B. R. nga ajo e referuar në kërkesën për vleftësimin e masës “arrest me burg”, “përkrahje e autorit të krimit” në “falsifikim të vulave, të stampave ose të formularëve”, lidhur me rrezikshmërinë e personit ka deklaruar se: *“Si pasojë e ankimit të bërë nga prokuroria, shtetasit në fjalë i është hequr aplikimi i nenit 59 të Kodit Penal, dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe kjo provon qartazi mungesën e qëllimit tim në përkrahjen apo favorizimin e këtij shtetasi”*.

### **Arsyetime ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

Komisioni, pas administrimit të shpjegimeve të paraqitura nga subjekti me shkrim pas rezultateve të hetimit dhe verbalisht në seancën dëgjimore, vlerëson se ato janë bindëse. Në analizë të fakteve, Komisioni vlerëson se veprimet hetimore të kryera nga subjekti i rivlerësimit kanë qenë të mjaftueshme për vlerësimin e kushteve dhe kritereve për masën e sigurimit.

### **27.2. Denoncim i shtetasës M. N., regjistruar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 31.5.2022, drejtuar subjektit të rivlerësimit dhe një subjekti tjetër rivlerësi, me objekt “vendimet e subjekteve janë të pakuptimta dhe antiligjore”**

Denoncuesja pretendon se vendimi i subjektit të rivlerësimit për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë 28.12.2020, është haptazi i paligjshëm dhe në kundërshtim të plotë me rrethanat, faktet, provat dhe pretendimet e ngritura në kallëzim nga ana e denoncuesit. Denoncuesi i ka bashkëlidhur denoncimit përkatësisht: (i) kërkesën për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë 28.12.2020; dhe (ii) vendimin datë 12.4.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, që ka vendosur pushimin e gjykimit të ankimit të ankueses M. N., pasi nuk ka objekt.

Nisur nga fakti që pretendimeve të denoncueses u është dhënë përgjigje edhe nga gjykata gjatë zhvillimit të proceseve dhe se nuk referojnë ndonjë provë apo shkelje konkrete nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni nuk gjeti *indicie* të ky denoncim për hetime të mëtejshme, në kuptim të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

### **27.3. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 6.3.2019, nr. \*\*\* prot., datë 15.3.2019 dhe nr. \*\*\* prot., datë 30.4.2019, i shtetasit I. M.**

Denoncuesi i ngre pretendimet kryesisht në lidhje me një kallëzim penal të regjistruar kundër shtetasit S. C. B. për përvetësimin padrejtësisht të pronës nëpërmjet dokumenteve të falsifikuara.

Komisioni i kërkoi Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dosjen e fashikullit përkatës për procedimin penal nr. \*\*\*, datë 4.6.2018, nga e cila ka rezultuar se:

- Mbi bazën e materialit kallëzues të shtetasit I. M. rezulton se në datën 23.4.2013, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, viti 2013, për veprën penale “falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal kundër shtetasit S. B.

- Në datën 23.4.2013 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka marrë urdhër për regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal.

- Në datën 10.6.2013 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur për zëvendësimin e prokurorit, duke caktuar si prokuror të çështjes subjektin e rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit ka kryer një sërë veprimesh hetimore, ku janë marrë në cilësinë e provës: aktet/certifikatat e pronësisë; nota e transkriptimit të pronës; praktikat e regjistrimit të pasurisë; kontrata e sipërmarrjes; si dhe është mbajtur procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijëni për veprën penale.

- Në datën 29.7.2013 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër, përfaqësuar nga subjekti i rivlerësimit, ka vendosur për pushimin e hetimeve të çështjes penale, duke arsyetuar si vijon: *“Vepra penale e kanosjes nuk është konsumuar, pasi mungojnë veprimet dhe përdorimi i mjeteve kërcënuese, si dhe koha që ka kaluar nga ai moment deri në momentin e kallëzimit penal të bërë nga kallëzuesi. Së dyti, ky shtetas nuk di të thotë saktësisht se cili është dokumenti për të cilin ai ka dyshime se është i falsifikuar, vendin dhe kohën që ky dokument është përdorur... Nga të gjitha aktet e administruara në fashikull nuk rezulton asnjë e dhënë konkrete, mbi bazën e së cilës mund të krijohet dyshimi se regjistrimi i pasurisë objekt konflikti është kryer mbi bazën e dokumenteve të falsifikuara”.*

Nga analizimi i fashikullit penal Komisioni vlerëson se pretendimet e denoncuesit për falsifikim nuk qëndronin, pasi ka rezultuar se nga ana e organit të akuzës janë kryer një sërë veprimesh hetimore, si dhe ndjekja penale për veprën penale të falsifikimit është parashikuar sipas nenit 66 të Kodit Penal. Komisioni mban në konsideratë edhe faktin se vendimi i pushimit i marrë nga subjekti i rivlerësimit është në përputhje me ligjin, duke u konfirmuar si i tillë edhe nga gjykatat më të larta me vendimmarrjet përkatëse.

#### **27.4. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 7.6.2018, i shtetasit S. K.**

Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit me vendimin për pushimin e hetimeve ka shkelur ligjin, pasi nuk ka proceduar personat përgjegjës, sikurse është referuar në materialin kallëzues të depozituar nga denoncuesi në datën 24.4.2016. Denoncuesi ka bashkëlidhur: (i) vendimin për pushimin e hetimeve të çështjes penale për procedimin penal nr. \*\*\*; (ii) vendimin nr. \*\*\*, datë 8.7.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me palë paditëse Gj. D. dhe palë të paditur S. K., me objekt detyrimin e të paditurit të pushojë cenimin e pjesshëm në pronësi ndaj paditëses, si dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar si pasojë e cenimit.



Nga analiza e vendimit për pushimin e hetimeve të çështjes penale për procedimin penal nr. \*\*\*, bashkëlidhur denoncimit, ka rezultuar se nga ana e organit të akuzës janë kryer një sërë veprimesh hetimore. Nisur nga fakti që pretendimet e denoncuesit nuk qëndrojnë, për vetë faktin se u është dhënë përgjigje edhe nga gjykata gjatë zhvillimit të procesit, Komisioni nuk gjeti *indicie* për fillimin e hetimeve të mëtejshme në kuptim të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

#### **27.5. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 22.10.2018, i shtetasit F. A.**

Komisioni konstatoi se denoncimi nuk përmbante përshkrimin e të dhënave për të vlerësuar shkeljen ligjore sipas kriterëve të rivlerësimit, veçanërisht për veprimin ose praktikën e dyshuar, pasojat ligjore, rrethanat për faktet që krijojnë bindjen se ka pasur shkelje ligjore nga subjekti i rivlerësimit, sipas pikës 2 të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni nuk gjeti *indicie* për fillimin e hetimeve të mëtejshme në kuptim të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

#### **27.6. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2021, i shtetasit Gj. L.**

Denoncuesi pretendon se vendimi i datës 4.12.2020 për “mosfillimin e procedimit penal” për kallëzimin penal nr. \*\*\* i subjektit të rivlerësimit është i kundërligjshëm. Denoncuesi ka bashkëlidhur vendimin datë 4.12.2020 për “mosfillimin e procedimit penal” për kallëzimin penal nr. \*\*\*.

Komisioni i kërkoi Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dosjen e fashikullit përkatës për procedimin penal. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.12.2022, informon se ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, viti 2020, mbi bazën e materialit kallëzues të referuar nga Komisariati i Policisë Shkodër me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.11.2020, sipas së cilës në urgjencën e spitalit rajonal është paraqitur për mjekim i dëmtuari Gj. L.

Në datën 4.12.2020 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër – subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka vendosur për mosfillimin e procedimit penal me arsyetimin se: *“Nuk konstatohen elemente të ndonjë vepre penale, pasi referuar të dhënave që ndodhen në fashikull, deklaratave të bëra nga i dëmtuari para specialistëve të zonës, si dhe pjesës përshkruese të aktekspertimit mjekoligjor, konfirmohet se i dëmtuari është rrëzuar për shkak të gjendjes shumë të dehur, ashtu edhe faktin që ky shtetas vuante nga probleme të abstinençës alkoolike”*.

Kundër vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në datën 16.12.2020, i dëmtuari Gj. L. ka paraqitur ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me objekt “kundër vendimit për mosfillimin e procedimit penal datë 7.12.2020 për kallëzimin penal nr. \*\*\*, viti 2020”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.1.2021, vendosi rrëzimin e kërkesës. I dëmtuari Gj. L. ka paraqitur ankim kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në Gjykatën e Apelit Shkodër. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.3.2021, ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 18.1.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër”, duke arsyetuar se organi i akuzës nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, pasi nuk gjen pasqyrim: (i) vendi ku është gjetur i dëmtuari dhe, në vijim, përshkrim i saktë i vendngjarjes në funksion të zbardhjes së rrethanave se si i kanë ndodhur*

*këto dëmtime; (ii) nuk gjejnë pasqyrim pretendimet e të dëmtuarit; (iii) nuk janë administruar pamjet e kamerave të sigurisë së objekteve që ndodhen në afërsi të vendit të ngjarjes; (iv) nuk janë marrë deklaramë nga persona që kanë dijeni për rrethana të dëmtimit të shtetasit, të cilët i kanë dhënë atij ndihmën e parë; (v) realizimi i një aktekspertimi mjekoligjor të ri, referuar faktit se i dëmtuari ka qëndruar në spital mbi një muaj”.*

Subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime në lidhje me veprimet dhe mosveprimet hetimore që kanë çuar në kryerjen e hetimeve të cunguara për zbardhjen e çështjes – siç është evidentuar edhe nga vendimi nr. \*\*\*, datë 17.3.2021, i Gjykatës së Apelit Shkodër, për kthimin pranë prokurorisë të akteve të procedimit penal dhe plotësimin e hetimeve.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, është shprehur se: *“Materiali kallëzues është përcjellë nga komisarati i policisë me një informacion për referimin e veprës penale për vlerësim, pa sugjeruar dhe as referuar ekzistencën e dyshimit për një vepër penale konkrete. Nga aktet bashkëlidhur këtij referimi rezultonte që i dëmtuari kishte deklaruar para inspektorëve të zonës që e kanë kontaktuar të parët, se ishte rrëzuar vetë pasi kishte qenë në gjendje të dehur dhe jo se ishte aksidentuar.*

*Një deklaramë i tillë konfirmohet nga akti përkatës i ekspertimit mjekoligjor, në pjesën përshkruese të të cilit referonte problem nga abstenenca alkoolike dhe është konstatuar se duhej dërguar për mjekim të specializuar për këtë shkak.*

*Në këto kushte, me aq të dhëna sa ishin dërguar bashkëlidhur materialit kallëzues në fjalë, nuk krijohet dyshimi për ekzistencën e asnjë veprë penale, përkundrazi, krijohet bindja se ky shtetas ishte rrëzuar për shkak të gjendjes së tij të dehur. Për pretendimet e të dëmtuarit kam ardhur në dijeni pas ankimit që ka bërë ky shtetas në momentin që ka marrë dijeni për vendimin në fjalë dhe menjëherë pas administrimit të vendimit të Gjykatës së Apelit, nga ana ime janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, të përcaktuara apo jo në vendimin në fjalë”.*

Subjekti paraqiti në cilësinë e provës ligjore fashikullin penal të procedimit penal nr. \*\*\*.

### **Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

Komisioni, pas administrimit të shpjegimeve të paraqitura nga subjekti me shkrim pas rezultateve të hetimit dhe verbalisht në seancën dëgjimore, e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në fazën e parë të administrimit të kallëzimit penal nr. \*\*\* nuk është konstatuar asnjë *indicie* për thellimin e hetimit.

Vendimi nr. \*\*\*, datë 17.3.2021, i Gjykatës së Apelit Shkodër, arsyeton se organi i akuzës nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore.

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në kryerjen e veprimeve hetimore të plota që do të çonin në zbardhjen e rrethanave të çështjes në këtë procedim penal. Veprimet hetimore të munguara, të cilat kanë çuar gjykatën në kthimin e akteve të procedimit penal nr. \*\*\* të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, janë përmendur edhe në vendimin nr. \*\*\*, datë 17.3.2021.

Komisioni, pasi administroi dhe vlerësoi shpjegimet e subjektit, mban qëndrimin se subjekti nuk arsyetoi bindshëm lidhur me gjetjet e Komisionit, por duke mbajtur në konsideratë sa

parashikohet nga vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese se *është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore të përsëritura dhe serioze dhe që tregojnë mungesë të aftësive profesionale*, vlerëson se ky denoncim i vetëm nuk mund të shërbejë si provë për cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë nga subjekti i rivlerësimit.

**27.7. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 6.9.2022, nr. \*\*\* prot., datë 12.5.2022, nr. \*\*\* prot., datë 11.5.2022, nr. \*\*\* prot., datë 23.11.2022, nr. \*\*\* prot., datë 9.12.2022 dhe nr. \*\*\* prot., datë 7.12.2022, i shtetases L. U.**

Komisioni i kërkoi Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dosjen e fashikullit përkatës për procedimin penal. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.12.2022, informoi Komisionin se ky procedim penal është në fazën e hetimeve dhe për efekt të ruajtjes së sekretit hetimor nuk mund të vendosin në dispozicion kopje të akteve deri në marrjen e një vendimi përfundimtar.

Sa më sipër, Komisioni çmoi se kontrolli i aftësisë profesionale nuk mund të kryhej për këtë çështje, sipas pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës pasi, për rrjedhojë, do të paragjykohej zgjidhja e një çështjeje në shqyrtim nga subjekti i rivlerësimit.

**27.8. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 12.11.2019, i shtetasit I. D.**

Lidhur me këtë denoncim drejtuar subjektit të rivlerësimit për moskryerje hetimi në lidhje me kallëzimin penal nr. \*\*\* për grabitje të pronës shtetërore, Komisioni i kërkoi Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dosjen e fashikullit përkatës për kallëzimin penal nr. \*\*\*.

Nga shqyrtimi i dosjes rezulton se në datën 24.11.2015, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër është regjistruar kallëzimi penal i shtetasit I. D. kundër trashëgimtarëve të familjes Xh., sipas të cilit në mashtrim të ligjit dhe nëpërmjet falsifikimeve kanë përfituar në mënyrë të padrejtë një sipërfaqe toke me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.3.1997, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Në datën 8.2.2016 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër, përfaqësuar nga subjekti i rivlerësimit, vendos mosfillimin e procedimit penal, duke argumentuar se: *“Kallëzuesi nuk pretendon që pala e akuzuar prej tij të ketë paraqitur në gjykimin e kryer në vitin 1997 ndonjë dokument konkret të falsifikuar. Pretendimi se gjatë gjykimit në vitin 1997 janë dhënë dëshmi nga persona që nuk mund të dëshmonin apo kanë mashtruar, referuar kohës kur është kryer ndjekja penale për këto fakte, bazuar në nenin 66 të Kodit Penal, janë parashkruar, si dhe duke pasur parasysh faktin se kallëzuesi nuk është dhe nuk ka qenë asnjëherë palë e interesuar apo e cenuar nga vendimi gjyqësor i vitit 1997”*.

Nga analizimi i materialeve në dosje subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime në lidhje me konstatimin se nga momenti i regjistrimit të materialit kallëzues deri në momentin e marrjes së vendimit të mosfillimit të procedimit penal në datën 8.2.2016 ka kaluar një periudhë prej rreth 2 muajsh. Nga të dhënat e pasqyruara si më sipër, vendimi për mosfillimin e procedimit penal është marrë jashtë afatit 30-ditor të parashkruar në udhëzimin nr. 3, datë 19.6.2012, “Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, ‘Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale’, i ndryshuar”, të Prokurorit të Përgjithshëm.

## **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, është shprehur se: *“Gjatë muajit dhjetor 2015, përveç marrjes pjesë në seancat përkatëse gjyqësore, ankimeve, konkluzioneve, delegimit të dosjeve, janë përfunduar me vendime mosfillimi, pezullimi, pushimi dhe dërgimi në gjyq 50 materiale kallëzuese. Në muajin janar të vitit 2016, siç e kam bërë të njohur për Komisionin, si pasojë e aksidentit shumë të rëndë të bashkëshortit në datën 8.1.2016, kam pasur një shkëputje të konsiderueshme nga puna, e cila ka bërë objektivisht të pamundur që vendimi i mosfillimit të merret brenda një afati të arsyeshëm apo afatit të parashikuar në udhëzimin e mësipërm. Gjithsesi, vendimi në fjalë i është njoftuar edhe Prokurorisë së Përgjithshme, pasi ishte dërguar si kallëzim nga ky institucion, si dhe së fundmi ankimi i këtij shtetasi nuk është pranuar as nga Gjykata e Lartë”*.

Subjekti paraqiti në cilësinë e provës dokumentacionin ligjor provues, vendimin nr. \*\*\*, datë 29.6.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, që ka vendosur rrëzimin e kërkesës së paraqitur nga shtetasi I. D. dhe lënien në fuqi të vendimit të datës 8.2.2016, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër “Mosfillimin e procedimit penal për kallëzim me nr. \*\*\*, viti 2015”. Vendimi mban shënimin që ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim nga kërkuesi në Gjykatën e Apelit Shkodër, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 12.10.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 29.6.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, si dhe Gjykata e Lartë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.11.2022, ka vendosur “Mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi I. D. kundër vendimit nr. \*\*\*, datë 12.10.2017, të Gjykatës së Apelit Shkodër”.

## **Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

Komisioni, pasi mori në analizë shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, arrin në përfundimin se vendimmarrja e subjektit dhe hapat proceduralë të ndjekur, që kanë çuar në këtë vendimmarrje, janë në përputhje me ligjin, duke u konfirmuar si të tilla edhe nga gjykatat më të larta me vendimmarrjet përkatëse.

### **27.9. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 18.5.2018, i shtetases L. H.**

Ky denoncim drejtuar subjektit të rivlerësimit dhe disa subjekteve të tjera në lidhje me vendimin nr. \*\*\* të Gjykatës së Apelit Shkodër, rikthyer për hetim, vërehen afate kohore të pajustificueshme në drejtim të zbatimit të vendimit gjyqësor. Denoncuesi i ka bashkëlidhur denoncimit disa dokumente.

Komisioni i kërkoi Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dosjen e fashikullit përkatës për kallëzimin penal nr. \*\*\*. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2023, vendosi në dispozicion kopje të fashikullit penal, duke evidentuar se procedimi penal i kërkuar me nr. \*\*\* është bashkuar me procedimin penal nr. \*\*\*, viti 2017, dhe ky i fundit është bashkuar me procedimin penal nr. \*\*\*, viti 2016, në një procedim të vetëm me nr. \*\*\*, viti 2016.

Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime në lidhje me sa u konstatua se: (i) nga momenti i caktimit të subjektit si prokuror i çështjes deri në momentin e urdhërimit për kryerjen e veprimeve hetimore shtesë ka kaluar një periudhë prej rreth 6 muajsh dhe gjatë kësaj periudhe nuk janë kryer veprime hetimore; (ii) nga aktet në dosje rezulton se subjekti i

rivlerësimit për këtë periudhë kohore nuk ka disponuar me vendim për zgjatjen e afateve të hetimeve, sipas kërkesave të nenit 324 të Kodit të Procedurës Penale.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, është shprehur se: *“Së pari, nga ana ime, gjatë 15 viteve punë, urdhrat e veprimeve hetimore janë nxjerrë menjëherë, maksimumi brenda 2-3 ditëve dhe nuk ka pasur kurrë hapësira të tilla kohore. Në rastin në fjalë, procedimi penal është dorëzuar nga prokurori i çështjes i zëvendësuar, me urdhër veprimesh hetimore dhe nga unë është marrë në dorëzim në datën 23.1.2017. Nisur nga fakti se në fashikull ishte një urdhër veprimesh hetimore, i marrë para dorëzimit të dosjes, nuk ka qenë e nevojshme nxjerrja e një urdhri të dytë për kryerjen e të njëjtit veprim hetimor që kishte urdhëruar prokurorja e mëparshme, por thjesht ia kam kaluar oficerit që kishte caktuar ajo prokurore. Urdhri i datës 28.6.2017 është përsëritje e urdhrat të mëparshëm të prokurorit tjetër, pasi në momentin që kam tërhequr dosjen në fjalë, me qëllim zëvendësimin tim dhe kalimin për hetim në seksionin përkatës, është konstatuar se nga oficeri nuk ishte vënë në lëvizje urdhri i mëparshëm i prokurorit. Kjo ka qenë arsyeja e kësaj hapësire kohore në marrjen e urdhrat të veprimeve hetimore.*

*Për sa i përket zgjatjes së afatit të hetimeve, sqaroj se për llogari të procedimit penal në fjalë, gjatë periudhës që unë e kam pasur në hetim, nuk ka pasur të regjistruar një emër personi si të dyshuar, për këtë arsye nuk ka qenë e detyrueshme zgjatja e afatit të hetimeve. Lidhur me konstatimin se ka afate kohore të pajustificueshme në drejtim të zbatimit të vendimit gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, lënë në fuqi me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.6.2015, të Gjykatës së Apelit Shkodër, pasi rezulton se regjistrimi i procedimit penal datë 3.10.2017, në zbatim të vendimit të gjykatës është kryer pas një periudhe kohore prej rreth 2 vjet e 2 muaj, sqaroj se ashtu siç rezulton edhe nga hetimi i bërë nga Komisioni, kjo nuk ka qenë në asnjë moment për fajin tim dhe as përgjegjësi imja. Përkundrazi, kjo vonesë rezulton e provuar se ka ndodhur për shkak të gabimeve të bëra nga punonjësit e kryesekretarisë dhe vendimi në fjalë i Gjykatës së Apelit më është kaluar në datën 2.10.2017, me shënim të Drejtuesit të Prokurorisë, bashkë me procesverbalin e konstatimit të gabimit të punonjësve të sekretarisë së vitit 2015. Nga unë është marrë në dorëzim ky vendim dhe procesverbali i konstatimit me datë 3.10.2017, kundrejt nënshkrimit përkatës, duke bërë menjëherë regjistrimin e tij si procedim penal. Referuar procesverbalit të konstatimit të gabimit, rezulton e provuar që ky vendim nuk më është vënë në dispozicion nga sekretaria e vitit 2015 dhe është gjetur në zyrën e një prokurori tjetër, bashkë me kopje të disa akteve të tjera”.*

### **Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

Komisioni, pas administrimit të shpjegimeve të paraqitura nga subjekti me shkrim pas rezultateve të hetimit dhe verbalisht në seancën dëgjimore, arsyeton si vijon subjekti, dha shpjegime bindëse në lidhje me kronologjinë e nxjerrjes së urdhrat për rikryerjen e veprimeve hetimore, urdhëruar nga prokurorja e mëparshme në datën 30.12.2016.

Në lidhje me zgjatjen e afateve të hetimit, subjekti ka dhënë shpjegime bindëse, pasi gjatë periudhës që subjekti i pasur në hetim nuk ka pasur të regjistruar një emër personi si të dyshuar dhe, për këtë arsye, nuk ka qenë e detyrueshme zgjatja e afatit të hetimeve. Ky veprim i subjektit të rivlerësimit është në përputhje me nenin 323, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale.

Komisioni, pas administrimit të shpjegimeve të paraqitura nga subjekti me shkrim pas rezultateve të hetimit dhe verbalisht në seancën dëgjimore, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm rrethanat e vonësës, ndodhur për shkak të gabimeve të bëra nga punonjësit e kryesekretarisë.

Vendimi në fjalë i Gjykatës së Apelit i është caktuar subjektit në datën 2.10.2017, me shënim të Drejtuesit të Prokurorisë, bashkë me procesverbalin e konstatimit të gabimit të punonjësve të sekretarisë së vitit 2015 dhe nga ky procesverbal rezulton e provuar se ky vendim nuk është vënë në dispozicion nga sekretaria e vitit 2015 dhe është gjetur në zyrën e një prokurori tjetër, bashkë me kopje të disa akteve të tjera.

#### **27.10. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 5.11.2020, i shtetasit Xh. H.**

Denoncuesi pretendon se subjekti ka cenuar çdo normë etike në mesazhet e dërguara, duke bashkëlidhur edhe mesazhet telefonike të subjektit. Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime lidhur me shprehjet drejtuar denoncuesit përgjatë komunikimit nëpërmjet mesazheve me denoncuesin.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, është shprehur se: *“Aktualisht, dy ankesat e këtij shtetasi janë në proces verifikimi në ILD dhe se është në pritje për të dhënë shpjegimet e mia rreth kësaj situatë.*

*Sjellja problematike e shtetasit Xh. H. dhe arsyet subjektive të tolerimit të tij nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër konfirmohen edhe nga përgjigjja e Drejtuesit të Prokurorisë Shkodër”.*

Subjekti paraqiti në cilësinë e provës dokumentacionin ligjor provues: (i) shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.2.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër që bashkëlidh kopje të praktikës për vlerësimin e kërkesës për procedimin disiplinor në ngarkim të shtetasit Xh. H.; (ii) shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 21.2.2023, të ILD-së, që informon se *ankesa e shtetasit Xh. H. ndodhet në fazën e shqyrtimit fillestar.*

#### **Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

Komisioni, në analizë të dokumentacionit të administruar, shpjegimeve të dhëna nga subjekti në tërësi, vlerëson se veprimtaria e subjektit të rivlerësimit, për këtë rast, duhet të jetë objekt i një hetimi të plotë nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, përgjegjës për hetimin e shkeljeve disiplinore ndaj prokurores dhe gjithë veprimtarisë së ushtruar prej saj që nëpërmjet inspektimit, marrjes së dëshmive dhe analizimit të marrëdhënies së subjektit me vartësin në fjalë të arrihet në një konkluzion sa më të bazuar në lidhje me këtë situatë.

Në konkluzion, sikundër provuar nga kthim përgjigjja nr. \*\*\* prot., datë 21.2.2023, e ILD-së, që informon se *ankesa e shtetasit Xh. H. ndodhet në fazën e shqyrtimit fillestar*, ky institucion, pas vlerësimit të të gjithë situatës dhe hetimit gjithëpërfshirës, do të vlerësojë nëse ka nga ana e subjektit shkelje disiplinore, bazuar në pikën 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

#### **27.11. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 2.12.2022, i shtetasit E. M.**

Sipas denoncuesit, me mosveprimet dhe veprimet e subjektit në procedimin penal nr. \*\*\*, datë 6.2.2018, ka favorizuar shtetasit, të cilët kanë kryer veprën penale “falsifikim i dokumenteve”,

si dhe nuk ka kryer detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. \*\*\*, datë 27.9.2019, me qëllim që shtetasit t'i shpëtonin dënimit.

Komisioni i kërkoi Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dosjen e fashikullit përkatës për kallëzimin penal nr. \*\*\*. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2023, vendosi në dispozicion kopje të fashikullit penal.

Nga shqyrtimi i dosjes, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime në lidhje me sa u konstatua: (i) sipas vendimit datë 23.2.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, lënë në fuqi me vendimin e Gjykatës së Apelit Shkodër, subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë një hetim të plotë në lidhje me kallëzimin e bërë dhe detyrat e lëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër; (ii) nga gjendja e akteve në dosje konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka disponuar me vendim për zgjatjen e afateve të hetimit për periudhat: nga momenti i caktimit të subjektit të rivlerësimit në cilësinë e prokurorit të çështjes për vazhdimin e hetimeve në datën 12.7.2021 deri në paraqitjen e kërkesës për pushimin e procedimit penal në datën 29.12.2021 ka kaluar një periudhë rreth 4 muaj; (ii) momenti i vendimit datë 28.4.2022, i Gjykatës së Apelit, që ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër deri në momentin e paraqitjes së kërkesës për pushimin e procedimit penal nga subjekti në datën 22.9.2022 ka kaluar një periudhë rreth 6 muaj. Ky veprim i subjektit të rivlerësimit duket se është në kundërshtim me pikat 1, 2 dhe 3 të nenit 324 të Kodit të Procedurës Penale.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, është shprehur se: *“Lidhur me sa më lart, theksoj që në rastin konkret nuk kam pasur asnjë detyrim ligjor të disponoj me zgjatjen e afatit të hetimeve, pasi për çështjen konkrete nuk ka pasur autor të dyshuar në regjistrin për njoftimin e veprave penale. Procedimi penal në fjalë ka qenë i regjistruar pa autor të dyshuar. Detyrimet e përcaktuara në nenin 324 të Kodit të Procedurës Penale i referohen rasteve të procedimeve penale për të cilat është regjistruar emri i të dyshuarit për kryerjen e veprës penale. Për këtë arsye nuk është bërë zgjatja e afatit të hetimeve dhe me kërkesën për pushimin e procedimit nuk është kërkuar pushimi i hetimeve ndaj askujt”*.

### **Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

Komisioni, pas administrimit të shpjegimeve të paraqitura nga subjekti me shkrim pas rezultateve të hetimit dhe verbalisht në seancën dëgjimore, konstaton se subjekti ka dhënë shpjegime në lidhje me hetimin e bërë, si dhe zgjatjen e afateve të hetimit gjatë periudhës që subjekti i pasur në hetim, pasi nuk ka pasur të regjistruar një emër personi si të dyshuar dhe, për këtë arsye, nuk ka qenë e detyrueshme zgjatja e afatit të hetimeve. Ky veprim i subjektit të rivlerësimit është në përputhje me nenin 323, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale.

**27.12. Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime lidhur me informacionin e datës 6.2.2023 nga [https://stop.tvklan.al\\*\\*\\*](https://stop.tvklan.al***).**

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, është shprehur se: *“Rasti në fjalë, shtetasja E. Sh. ka bërë disa herë kallëzime penale në prokurori. Në rastin konkret, konflikti mes palëve lidhet me një ndërtim pa leje që kallëzuesja pretendon dhe prishjen e këtij ndërtimi pa leje, i cili nuk është ndjekur dhe as ndiqet në hetim nga ana ime.*

*Nga unë është ndjekur vetëm pretendimi i kësaj shtetaseje se është rrahur dhe se i është dëmtuar telefoni. Mosfillimi i hetimeve është bërë bazuar në aktin përkatës mjekoligjor.*

*Ndërsa, pretendimi i kallëzueses për dëmtimin e aparatit të saj celular bazohej vetëm në thëniet e saj dhe në asnjë provë tjetër. Ekzistenca e veprës penale 'shkatërrim prone' është një vepër e cila kërkon domosdoshmërisht vërtetimin e pasojës jo të lehtë, rrethanë kjo e cila në kushtet kur nuk ka asnjë provë që vërteton llojin e aparatit celular që ka pasur, kohën kur e ka blerë, çmimin e blerjes apo faktin nëse aparati celular është dëmtuar tërësisht apo pjesërisht, e bën të pamundur vërtetimin e ekzistencës së kësaj figure vepre penale. Për rastin në fjalë është bërë ankimi në Gjykatën e Apelit Shkodër dhe çështja është ende në shqyrtim, nuk ka një vendim të formës së prerë lidhur me vendimin e mosfillimit të marrë nga unë”.*

### **Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

Komisioni, pas administrimit të shpjegimeve të paraqitura nga subjekti me shkrim pas rezultateve të hetimit dhe dokumentacionit të administruar në cilësinë e provës, arrin në përfundimin se për sa çështja është ende në gjykim në kuptim të nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, ku parashikohet se *vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim* nuk mund të shtrihet vlerësimi profesional për këtë çështje.

### **Qëndrimi i Komisionit mbi denoncimet**

28. Trupi gjykues, pasi analizoi denoncimet e mësipërme sipas ligjit nr. 84/2016 dhe pasi analizoi shpjegimet e dhëna dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, nuk konstatoi të dhëna, prova dhe fakte lidhur me veprime korruptive apo shkelje ligjore të subjektit të rivlerësimit dhe nuk gjeti elemente që përbëjnë dyshime për paaftësi profesionale apo që cenojnë figurën e prokurores.

28.1. Komisioni, pasi administroi dhe vlerësoi shpjegimet e subjektit, mban qëndrimin se subjekti nuk arsyetoi bindshëm lidhur me gjetjet e Komisionit dhe me denoncimin e denoncuesit Gj. L., por duke mbajtur në konsideratë sa parashikohet nga vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese vlerëson se për sa ky ishte një rast i vetëm ai nuk shërben si provë për cenimin e besimit të publikut të sistemi i drejtësisë nga subjekti i rivlerësimit.

## **KONKLuzion Përfundimtar**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Shqiponja Milla:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, në bazë të nenit 51, germës “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,



## **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Shqiponja Milla, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 2.3.2023.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Olsi KOMICI**  
**Kryesues**

**Xhensila PINE**  
**Relatore**

**Firdes SHULI**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Jonida Vrana*